

Punëtor/e Social/e në Fushë Kosovë

Terre des hommes Foundation Misioni në Kosovë është duke kërkuar të rekrutojë Punëtor/e Social/e në Fushë Kosovë si pjesë e programit të mbrojtjes së fëmijëve.

Projekti: Projekti "Rrjeti i Sigurisë së Mbrojtjes së Fëmijëve - Faza IV" – përkrahur nga fondacioni Medicor

Lloji i Kontratës: Kontratë punësimi me afat të caktuar kohor

Data e fillimit të punës: Korrik 2022

Kohëzgjatja: 8 muaj

Lokacioni: Fushë Kosovë /Qendrën për Punë Sociale

INFORMATË E PËRGJITHSHME:

Misioni Terre des hommes në Kosovë është një organizatë jo-fitimprurëse që operon në Kosovë nga viti 1999 në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke udhëhequr krijimin dhe forcimin e një sistemi kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë. Fushat e ekspertizës të Tdh-së variojnë nga ndërhyrjet e drejtpërdrejta psiko-sociale me fëmijë të cënueshëm dhe familjen e tyre dhe anëtarët e komunitetit, në fuqizimin e institucioneve të nivelit lokal, rajonal dhe kombëtar, dhe akterëve kryesorë përmes ndërtimit të kapaciteteve dhe trajnimit në vend të punës në mënyrë që të zhvillohen dhe të zbatohet strukturat, politikat, standardet dhe procedurat e duhura të ndjeshme ndaj fëmijëve.

Programet kryesore të ndërhyrjeve në Tdh Kosova3: 1) Mbrojtja e fëmijëve 2) Migrimi dhe Anti-trafikimi dhe 3) Drejtësia për të Mitur.

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME NË LIDHJE ME PROJEKTIN:

Terre des hommes përmes projektit "Rrjeti i i Sigurtë për Mbrojtjen e Fëmijëve (faza 4)" synon të arrijë zhvillimin e një sistemi plotësisht funksional të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të sigurojë që fëmijët në Kosovë të mbrohen më mirë nga abuzimi, neglizhimi dhe shfrytëzimi përmes ndërtimit të sistemit efektiv të mbrojtjes së fëmijëve.

Terre des hommes Kosova gjatë viteve të zbatimit të projektit ka një rol vendimtar për të luajtur në mundësimin e funksionalizimit të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve - i cili siguron bazat e përfshirjes sociale dhe konsolidon sistemin e përgjithshëm të mbrojtjes së fëmijëve në vend. Prandaj, përmes projektit Tdh Kosova synon të luajë një rol të rëndësishëm në avokim dhe duke ofruar mbështetje për këtë reformë të rëndësishme duke siguruar që shërbimet për fëmijët të jenë pjesë e saj.

Punetori Social per mbrojtjen e fëmijëve të angazhuar nga Terre Des Hommes

Ne linkun e mëposhtëm mund të gjeni konkursin me detaje

<https://portalpune.com/posted-job/terre-des-hommes-child-relief-pun-tor-e-social-e-n-fush-kosov->